



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës
04 Nr. 111-39926/2015
Kaçanik, 10.11.2015

Në bazë të nenit 5 pika(c) të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr.03/L-068, nenit 35 të Ligjit për Arsim Parauniversitar Nr.04/L-032, nenit 8 të Ligjit të punës Nr.03/L-212 dhe Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.06/2015 Për Normativ mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit shpallë:

K O N K U R S

Për plotësimin e vendeve të lira të punës

1. Shkolla fillore e mesme e ulët „Emin Duraku” në Kaçanik:

- **Shkolla amë në Kaçanik:**
Dy mësimdhënës të lëndës; Edukatë Muzikore, njëri me 7 orë .
- **Paralelja e ndarë në Gjurgjedell:**
Një mësimdhënës i lëndës; Gjuhë dhe Letërsi Shqipe.

2. Shkolla fillore e mesme e ulët „Idriz Seferi” në Bob:

Një mësimdhënës i mësimin klasor, paralelja e ndarë fizike në Kovaçec- zëvendësim.

3. Qendra për Edukim dhe Arsim Parashkollor “Agimi” në Kaçanik

Një Edukatore - zëvendësim.

Kushtet e Konkursit:

Për vendet e punës të shënuar më lartë, kërkohet përgatitja përkatëse profesionale sipas Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.06/2015 Normativi mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm .

Kandidatët të cilët aplikojnë për këto vende pune, përveç kushteve të përgjithshme të parapara me ligj, duhet ti plotësojnë edhe kushtet e veçanta: diploma e fakultetit përkatës, ekstrakti i lindjes, kopjen e letërnjoftimit, dëshmi mbi përvojën e punës në arsim, dhe certifikata të trajnimeve të akredituara nga MASHT .

Të drejtë aplikimi në konkurs kanë kandidatët e degës përkatëse.

Sqarime shtesë :

Të gjitha dokumentet gjatë aplikimit duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen , ndërsa origjinalin duhet ta sjellin në ditën e intervistimit .

Afati dhe mënyra aplikimit.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në shërbimin e shkrimores-**Zyra e Pranimit**, kati përdhes. Dokumentet e pa kompletuara dhe të dorëzuara pas afati nuk do të shqyrtohen.

Kandidatët për seleksionim dhe intervistim do të njoftohen përmes tabelës së shpalljeve publike.

Afati për paraqitjen e aplikacioneve është 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik.

Drejtori i drejtorisë;
Enver Kamishi

